


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Italinë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkëmbimi tregtar me Italinë¹, në vitin 2025 deficitit tregtar ka shënuar një rritje prej 16.0% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke arritur në -340.5 milionë euro nga -293.5 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti mbetet e ulët në rreth 7.8%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Italinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	46.4	38.7	37.4	28.9
Import	275.9	287.5	330.9	369.4
Bilanci tregtar	(229.5)	(248.8)	(293.5)	(340.5)
% e mbulimit	16.8%	13.4%	11.3%	7.8%
Rritje Exp. (v-m-v) %	-22.3%	-16.6%	-3.3%	-22.7%
Rritje Imp. (v-m-v) %	0.3%	4.2%	15.1%	11.6%
Bila. Treg. (v-m-v) %	6.5%	8.4%	18.0%	16.0%


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹ Italia, zyrtarisht Republika Italiane, është një vend në Evropën Jugore, në Gadishullin Apenin, me kryeqytet Romën. Ka një sipërfaqe prej 301,340 km² me rreth 59 milionë banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rreth 2.38 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 43,161 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 8-të më e madhe në botë nominalisht sipas FMN-së.

Analizuar në periudhën e fundit marrëdhëniet tregtare të mallrave ndërmjet Kosovës dhe Italisë karakterizohen nga një deficit i lartë dhe i vazhdueshëm tregtar në favor të Italisë gjatë periudhës 2022–2025. Eksportet e Kosovës drejt Italisë viteve të fundit kanë trend në rënie me një mesatare vjetore prej -16.2%, ndërsa importet kanë shënuar një rritje mesatare vjetore rreth 7.8%. Importet nga Italia (në sasi dhe në vlerë) dominojnë dukshëm ndaj eksporteve të Kosovës, duke reflektuar varësinë relativisht të madhe të tregut kosovar nga produktet italiane.

Si rezultat i këtij trendi të pabarabartë tregtar, bilanci tregtar i mallrave ka mbetur vazhdimisht negativ për Kosovën. Tregusit e mbulueshmërisë tregojnë një pabarazi të thellë, shkalla e mbulimit të importeve me eksporte kanë shënuar rënie nga 16.8% sa ishte në vitin 2022 në rreth 7.8 % në vitin 2025.

Figura 2. Eksport/Importi me Italinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Itali ishin rreth 28.9 milionë euro apo 3.1% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, renditet në grupin e top 10 vendeve kryesore të eksporti.

Importi i mallrave nga Italia arritën në 369.4 milionë euro apo 5.2% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm, renditet e katërta në listën e 10 vendeve kryesore të importet.

Struktura e Eksportit/Importit me Itali në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesore të Eksportit e përbëjnë: 22.0% Produkte të industrisë kimike; 19.5% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 16.9% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi; 16.2% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 5.3% Produkte bimore; 4.8% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 4.2% Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj) etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Italianë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)


Rënia e eksporteve për 22.7% apo rreth 8.5 milionë euro më pak mallra në tregun italian në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia te sektorët si, Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre (nga 24.1% në 16.2%), Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj) (nga 7.3% në 4.2%) dhe te Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 6.5% në 4.8%) etj.

Eksportet e Kosovës drejt Italisë karakterizohen nga një përqendrim i lartë, ku vetëm katër sektorët kryesorë (industria kimike, ushqimet, artikujt prej guri/qelqi dhe plastika) përbëjnë rreth 68.0% (v. 2024) dhe rreth 74.7% (v. 2025) të vlerës totale të eksportuar për vitet dy vitet e fundit.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 17.1% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 16.5% Ushqimet e përgatitura, pijet

dhe duhani; 12.5% Produkte minerale; 12.0% Produkte të industrisë kimike; 8.6% Produkte bimore; 8.4% Mjetet e transportit; 6.4% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Italia.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 11.6% apo rreth 38.5 milionë euro më shumë mallra të importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Produkte minerale (nga 9.0% në 12.5%), Mjetet e transportit (nga 5.6% në 8.4%), dhe një rritje e lehtë të Produkte bimore (nga 7.4% në 8.6%).

Sektori i Ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit përfaqëson një pikë të rëndësishme të shkëmbimit dypalësh, duke u renditur si kategoria e dytë më e tregtuar si në eksport (19.5%) ashtu edhe në import (16.5%) gjatë vitit 2025.

Dominimi i Makinerive dhe pajisjeve mekanike e elektrike me 17.1% në strukturën e importeve tregon varësinë e vazhdueshme të tregut dhe industrisë kosovare nga teknologjia dhe prodhimet industriale italiane.